




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmjeno/Pradato Received/Delivery	14	12	2021	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKDPM/SHCK	6120/2021		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.913/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bektashi Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1079/20, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.136/2020 të datës 27.04.2020, të parashtruar nga ankuesja

me adresë banimi rruga "Muharrem Fejza" p.n, Lagjia e Spitalit, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.136/2020 e datës 27.04.2020, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KZKA/1664 i datës 06.04.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në Drejtorinë e Akreditimit të Kosovës, me datë 20.04.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 784/2020 të regjistruar me numër A.nr.136/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KZKA/1664 të datës 06.04.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 29.04.2020, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses të Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Këshilli, me datë 29.04.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi të njëjtën kohë ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktgjykimit A.nr.1079/20 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 27.04.2020 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 784/2020 të regjistruar me numër A.nr.136/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 11.06.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.04.2020; Përgjigjen në ankesë të datës 29.04.2020 me shkresat e bashkangjitura; Ankesën e datës 06.03.2020 të ankueses të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Kërkesën e datës 23.01.2020 për pagesë sipas koeficientit nga ankuesja; Vendimin e datës 06.04.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit të datës 10.10.2014 të ankueses se bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Akt Emërimit të datës 02.02.2012 të ankueses se bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Listën e pagave për muajin janar 2020; Kërkesën për ndryshim të Akt Emërimit të datës 04.05.2014 të ankueses; Kërkesën për pagesë sipas koeficientit, të datës 23.01.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pabazuar sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit të datës 02.02.2012 është konstatuar se ankuesja ka qenë e emëruar në pozitën e punës Zyrtare e për Akreditimin e Laboratorëve Testuese ndërsa sipas Ndryshimit dhe Plotësimin e Akt Emërimit të datës 10.10.2014, e njëjta me datë 10.10.2014 është emëruar në pozitën e punës Zyrtare e lartë për Akreditimin e Laboratorëve Testuese dhe Kalibruese pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. E njëjta sipas këtij akti të emërimit ka të përcaktuar koeficientin e pagës shtatë (7).

Ankuesja me datë 06.03.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA) pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ky i fundit me datë 06.04.2020 ka nxjerr Vendimin KZKA-1664 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa pranueshme me arsyetimin se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Kundër Vendimit KZKA-1664 të datës 06.04.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për harmonizimin e koeficientit të pagës konform ndryshim plotësimit të Akt Emërimit.



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja me datë 10.10.2014 ka nënshkruar Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit për pozitën e punës Zyrtare e lartë për Akreditimin e Laboratorëve Testuese dhe Kalibruese, me koeficient të pagës shtatë (7), ndërsa ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka parashtruar me datë 06.03.2020. Bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se parashtrimi i ankesës është bërë jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, siç ka qenë i përcaktuar me legjislacionin e aplikueshëm, gjegjësisht dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, përkatësisht nenin 130 ku parashihej se: *Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes se Kontesteve dhe Ankesave, përkatësisht nenin 8 paragrafi 2 ku parashihej se: 2. Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur te drejtat e tij nga marrëdhënia e punës, kështu që Kolegji vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me rastin e nxjerrjes së Vendimit KZKA-1664 të datës 06.04.2020, për refuzimin e ankesës si të pa papranueshme ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes se Kontesteve dhe Ankesave.*

Andaj, bazuar si me lartë u konstatua se A.nr.136/2020 e datës 27.04.2020 është e pa bazuar, kështu që duke u mbështetura në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.913/2021

Avdyl Bektashi

[Signature]
Procesmbajtes



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MINT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

